

SHKUPI

LAJMËTARI INFORMATIV I QYTETIT TË SHKUPIT

NUMËR PA
PAGESE

СКОПЈЕ

Numër 11 Viti III Janar 2010



2010

VITI I SFIDAVE TË REJA



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Kryeredaktor
Nedelço Krstevski

Zëvendës kryeredaktor
Lupço Pandilovski

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografisë
Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektor
Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit
Koce Trajanovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni:
Evropa 92 - Kočanë



Të nderuar bashkëqytetarë,

Para Jush është botimi festiv i Lajmëtarit informativ të qytetit në të cilin u përpoqëm t'Ju prezantojmë projektet që i realizuam gjatë këtij viti.

Hapësira e Lajmëtarit informativ është shumë e ngushtë për të prezantuar edhe njëherë shkurtimisht të gjitha projektet që i filluam dhe i realizuam. Kjo do të thotë se ky vit ishte i frytshëm dhe një pjesë e mirë e programeve për vitin 2009 është realizuar.

Ky vit u karakterizua nga përmirësimi i higjienës komunale, rregullimi i Parkut të qytetit, përfunduar disa zgjerime të rëndësishme të rrugëve, filluam zgjerimin e bulevardit Serbia, përmirësuar kapacitetin e punës së ndërmarrjeve publike dhe po punohet edhe në përmirësimin e infrastrukturës.....

Në përgjithësi, mund të konstatojmë se janë realizuar 90 për qind e projekteve të planifikuara, është ruajtur stabiliteti financiar i Qytetit të Shkupit, vendosëm novitete në jetën kulturore të përditshme të qytetit, filluam projekte të rëndësishme infrastrukturore.

Kursi i aktiviteteve në vitin e ardhshëm është vendosur. Së bashku edhe në vitin e ri do të hyjmë me projekte të reja nga fusha e komunikacionit, urbanizmit, veprimtarive komunale.....

Buxheti për vitin 2010 sjell sfida të reja, të cilat në bashkëpunim me qytetarët, Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Këshillin e Qytetit të Shkupit, administratën e qytetit dhe komunat e Shkupit do t'i realizojmë, me qëllim që të ndërtojmë vizionin për një Shkup modern dhe urban.

Të nderuar,

Me dëshirë për shumë shëndet, lumturi personale dhe harmoni familjare Ju uroj gëzuar Vitin e Ri 2010 dhe festat e Krishtlindjeve.

Koce Trajanovski
Kryetar i Qytetit të Shkupit

Gëzuar festat e fundvitit



„SË BASHKU PËR SHKUPIN E PASTËR DHE TË GJELBËR”

Aksioni i madh për pastrimin e Shkupit nën moton “Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbër” u realizua me sukses të madh. Aksioni, i iniciuar nga kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, u realizua në bashkëpunim me dhjetë komunat e Shkupit. Ekipet e ndërmarrjeve publike të qytetit “Higjiena komunale”, “Parqe dhe gjelbërime”, “Ujësjetës dhe kanalizime” dhe “Rrugë dhe rrugica” u mobilizuan dhe u angazhuan në mënyrë maksimale në pastrimin e Shkupit.

Gjatë aksionit i cili zgjati nga data 11. 05 deri më 18.06.2009, në territoret e dhjetë komunave të Shkupit u kosit bari, u ngritën mbi 2.000 metër kub mbeturina nga : deponitë informate, u krasitën kurorat e drurëve, degët e thata u prënë dhe u fshinë e u lanë rrugët.

SË BASHKU PËR SHKUPIN E PASTËR DHE TË GJELBËR do të vazhdojë të realizohet në mënyrë të vazhdueshme në suazat e programeve komunale të Qytetit të Shkupit dhe bashkëpunimit ndër komunal në qytet.



PIKA INTERNETI FALAS

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, këtë verë, lëshoi në përdorim internetin ajror falas në Parkun e Qytetit (në pjesën përballë barakave të administratës së Qytetit të Shkupit) dhe në parkun "Zhena borec". Me këtë qytetarëve të Shkupit u mundësohet qasje në internetin ajror falas, pa fjalëkalim dhe mund ta shfrytëzojë çdo person që ka lap top ose aparat tjetër, si telefon celular, që ka mundësi për lidhje ajrore.


PAMJE E RE E PARKUT TË QYTETIT

Qyteti i Shkupit gjatë vitit 2009 realizoi shumë aktivitete për zbukurimin e Parkut të qytetit. Janë vendosur 100 kosha të rinj për mbeturina në pjesën e parë të Parkut të qytetit dhe 50 kosha për mbeturina në pjesën e dytë të parkut; Është bërë rikonstruksioni dhe janë lyer stolat në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit; Janë prerë drurët e vjetër dhe të thatë që kërcënonin sigurinë e kalimtarëve; Janë prerë degët dhe janë krasitur kurorat e drurëve; Janë vënë bordura të reja për lule,

janë mbjellur trëndafila dhe lule të tjera sezonale; Janë vendosur shtylla dhe barriera për të penguar hyrjen e automjeteve në parkun e qytetit; Është vendosur zhavorr i bardhë në pjesën e parë të Parkut të qytetit; Janë pastruar liqenet në pjesën e parë dhe të dytë të Parkut të qytetit; Janë vendosur pllaka begatoni në sheshin para guaskës; Janë vendosur 1200 zhardinierë të rinj dhe barrierë hyrëse; Është shpallur konkurs për zgjidhje ideore për rregullimin e parterit dhe hortikulturës të lokalitetit

në Parkun e qytetit; Janë vendosur gjithsej 160 shtylla në drejtimin nga barriera tek Kopshti zoologjik për të pamundësuar hyrjen e automjeteve në këtë pjesë të Parkut të qytetit. Filloi rikonstruksioni i nyjave sanitare në Parkun e qytetit.

Qyteti i Shkupit, për pamjen e re të Parkut të qytetit, ndau 8.328.714 denarë, kurse një pjesë e përmbajtjeve të reja u siguruan me donacione nga Ambasada e Mbretërisë Holandeze dhe Pro-kredit banka.



NP "HIGJIENA KOMUNALE" PAJISJET ME GJASHTË KAMIONË TË RINJ PËR MBETURINA

Kamionët e rinj janë me kapacitet 16 metër kub, me mekanizëm të instaluar për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve standardë me kapacitet 1,1 metër kub dhe kosha për mbeturina me kapacitet 120 dhe 240 litra. Ekziston edhe mundësia për drejtimin automatik dhe manual të ciklit të punës.

Qyteti i Shkupit, planifikon në vitin 2010 të bëjë furnizimin edhe me 12 automjete për NP "Higjiena komunale".



PAJISJE EDHE PËR STACIONARIN VARDARISHTË

Trajtimi human dhe gjuetia e qenve endacakë inicio nevojën e investimeve plotësuese nga Qyteti i Shkupit në zgjerimin e stacionarit, si dhe furnizimin me pajisje të reja.



MEKANIZIM I RI PËR NP "PARQE DHE GJELBËRIME"

Qyteti i Shkupit bëri furnizimin edhe me makinë të re për shkuljen e trungjeve që është destinuar për nevojat e NP "Parqe dhe gjelbërime". Makina në të njëjtën kohë edhe hap kanale edhe ngarkon dhe është makina e parë e këtij tipi me të cilën disponon NP "Parqe dhe gjelbërime". Deri në fund të vitit presim të arrijnë edhe 4 makina të reja të cilat do ta lehtësojnë punën e NP "Parqe dhe gjelbërime".



PASTRIMI LUMIT VARDAR


Gjatë këtij viti Qyteti i Shkupit në disa faza realizoi pastrimin shtratis të lumit Vardar. Faza e parë përfshiu pastrimin manual të shtratis të lumit Vardar dhe u pastruan pjerrësitë e shtratis të vogël të lumit Vardar.

Fazat përfundimtare përfshinë pastrimin me mekanizim, ku u pastruan, ngritën dhe u transportuan 5.000 metër kub lym, 30.000 metër kub lymishtë u rrafshuan me makineri, kurse u mbushën edhe të gjitha gropat dhe pjesët e parrafshëta në fundin e shtratis.



ZËVENDËSIM I LLAMBAVE NDRIÇUESE NË RRUGËT E SHKUPIT

Qyteti i Shkupit në suazat e këtij projekti do të kryejë zëvendësimin e llambave ndriçuese në një pjesë të rrugëve magjistrale dhe mbledhëse, mbi 3.000 llamba në 60 rrugë, duke siguruar kështu ndriçim më me kualitet dhe kursim të energjisë elektrike për rreth 30%. Për furnizimin me llamba janë parashikuar 28.119.000 denarë, kurse për zëvendësimin e llambave 8.220.000 denarë. Llambat janë prodhim i kompanisë së njohur botërore për ndriçim Minel-Schreder.



Qyteti i Shkupit filloi projektin-pilot për kompostim

GJETHET E RËNA DO TË SHNDËRROHEN NË PLEH NATYROR ME KUALITET

Gjethet e rëna që mbledhen nga sipërfaqet e gjelbra do të shndërrohen në pleh natyror me kualitet – komposto, në projektin-pilot për kompostim që javën e kaluar e filloi Qyteti i Shkupit dhe NP "Parqe dhe gjelbërim". Për këtë qëllim, në oborrin e NP "Parqe dhe gjelbërim" është hapur një gropë me dimensione 30x30 metra dhe me thellësi 1,5 metra në të cilën do

të vendosen gjethet e pastruara nga mbeturina të tjera që do të mbledhen nga gjelbërimi (degë, letra dhe plastikë). Gjethet e rëna në mënyrë natyrore do të kalben dhe do të shndërrohen në pleh i cili do të shfrytëzohet për nevojat e NP "Parqe dhe gjelbërim". Kompostoja pritet të formohet për rreth një vit.

DONACION PREJ 1300 KONTEJNERË DHE 4500 KOSHA PËR MBLEDHJEN E MBETURINAVE

Në suazat e aksionit "Së bashku për Shkupin e pastër dhe të gjelbër" filloi vendosja e kontejnerëve për mbeturina shtëpiake, donacion nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Në Shkup, në bashkëpunim me komunat, janë vendosur 1300 kontejnerë të rinj.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përveç kontejnerëve, Qytetit të Shkupit i dha donacion 4.500 kosh për mbledhjen e mbeturinave shtëpiake, me kapacitet 120 litra.



AKTIVITETE KOMUNALE

Qyteti i Shkupit, në suazat e aktiviteteve programore, filloi dhe realizoi shumë aktivitete komunale. Një pjesë e projekteve janë realizuar në bashkëpunim me komunat dhe Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve.



Në fazën përfundimtare është puna me kanalizimin e ri atmosferik në rrugën Ilindenska.



Po kryhet rrjeti i ujësjellësit në Maxhari në rrugën Pero Nakov.



Në suazat e veprimtarive komunale është rinovuar edhe vend vrojtimi në Vodno, kurse është intervenuar edhe në peizazhin karakteristik Gazi Baba.



Janë vendosur pesëdhjetë hidrantë për nevojat e brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit, në shumë rrugë në qytet.



Po kryhet kanalizimi fekal për lagjet Lisiçe dhe Gorno lisiçe.

- Është kryer zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit në Gorna Vranovska dhe Bozhin Nikolov.
- Në përfundim e sipër është realizimi i kanalizimit fekal Inxhikovo.
- Qyteti i Shkupit, për nevojat e qytetarëve të Shuto Orizari realizoi hidrofor të ri me tubacion nën presion



Për të përmirësuar kualitetin e furnizimit me ujë filloi vendosja e ujë matësve për leximin në largësi, me të cilët do të zvogëlohen humbjet e ujit.



Është përfunduar kanalizimi atmosferik tek USJE.



Pjesëmarrje në realizimin e stacionit të pompimit Gorno Lisiçe.



U MBOLLËN 130 BREDHA NË ZHARDINIERËT NË BULEVARDIN JANE SANDANSKI

Zhardinierët që zbukurojnë bulevardet e Shkupit morën një pamje hortikulture dhe të gjitha janë mbjellë me bar, kurse në periudhën e ardhshme do të mbillen edhe me fidanë të tjerë.

Këto ditë janë mbjellë 130 bredha të argjendte dhe të gjelbër në zhardinierët në bulevardin Jane Sandanski, në drejtimin nga Stacioni ri hekurudhor deri në "Majčin dom". Bredhat janë mbjellë në linjë të drejtë në të dyja anët.

PASTRIM I KANALEVE

Janë pastruar kanalet në Inxhikovo, kanali Vodnjanska dhe u pastrua edhe kanali qëllimor në Krushopek që furnizon liqenet në Parkun e qytetit me ujë të rrjedhshëm.



NDËRTIM DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËVE TË QYTETIT

Muaji nëntor solli aksionin e madh për riparimin e gropave në të 18-të rrugët dhe bulevardet e qytetit të Shkupit. Për një ditë u mbushën mbi 1000 metër katror gropa nëpër rrugë.

Është rinovuar rruga në pjesën e bulevardit Nikolla Karev.

Janë përfunduar punët ndërtimore për zgjerimin e udhëkryqit dhe rrugëve rreth udhëkryqit tek Kombinati i duhanit.

Është kryer rikonstruksioni i plotë i rrugës nga Kopanica deri në Rashçe, është kryer rikonstruksioni i një pjese të rrugës 31 në Shuto Orizari.

Qyteti i Shkupit u ndihmoi komunave në rikonstruksionin e rrugëve të komunave.

KOMUNIKACION

Qyteti i Shkupit po përfundon aktivitetet për vendosjen e korridorit të gjelbër në qarkullim. Për këtë qëllim janë zëvendësuar kontrollorët në të gjitha udhëkryqet, janë pajisur semaforët me numërues dhe është realizuar lidhja e tyre.

Së shpejti do të fillojë instalimi i 400 semaforëve të rinj të cilët punojnë me dioda ndriçuese.



PO NDËRTOHET KORSIA E PATINAVE- BIÇIKLETAVE NË ANËN E MAJTË TË LUMIT VARDAR

Tetë milion denarë do të kushtojë ndërtimi i korsisë së re të patinave-biçikletave, të cilën Qyteti i Shkupit më 30 tetor filloi ta ndërtojë në anën e majtë të lumit Vardar. Korsia nga Ura e Gurit deri te fabrika "Komuna" do të jetë katër metër e gjerë dhe e gjatë 1.800 metra.



U LËSHUA NË PËRDORIM KORSIA E PATINAVE-BIÇIKLETAVE NË BREGUN E LUMIT VARDAR

Korsia e patinave-biçikletave, e gjatë 2.600 metra, e gjerë 4 metra, u hap në mënyrë solemne më 28 korrik 2009. Korsia gjendet në bregun e lumit Vardar, fillon nga Qendra transportuese dhe shtrihet deri te ura "Bliznak". Për ndërtimin e saj Qyteti i Shkupit investoi pesë milion denarë.

RRUGË HYRËSE NGA VOLLKOVO DERI NË UNAZËN VERIORE

U lëshua në përdorim rruga hyrëse që do të çojë deri në stacionin e fundit të autobusit me numër 22 në Vollkovo deri në unazën veriore. Rruga është e gjatë 846 metra, me dy korsi prej 3,5 metra dhe trotuare prej 2,5 metra. Për rrugën hyrëse u ndanë 12 milion denarë nga arka e qytetit.



FILLOI ZGJERIMI I PJESËS SË DYTË TË BULEVARDIT SERBIA

Qyteti i Shkupit më 26 korrik filloi zgjerimin e pjesës së dytë të bulevardit Serbia, nga udhëkryqi me bulevardin Vidoe Smilevski Bato deri te rruga Prvomajska. Deri tani janë depërtuar dhe asfaltuar 700 metra, kurse gjatësia e përgjithshme e pjesës e cila po zgjerohet është 1.720 metra. Ndërtimi do të kushtojë dy milion euro.



UDHËKRYQI “TËRFILI” ZVOGËLOI KAOSIN NË BULEVARDIN KRSTE MISIRKOV

Udhëkryq modern me disa nivele në formën e tërfilit rriti rrjedhën e qarkullimit në mbikalimin në bulevardin Krste Misirkov, në Bit Pazar. Me zgjidhjen e re të qarkullimit në mënyrë të plotë është eliminuar përdorimi i semaforëve, kurse automjetet lëvizin në principin e kthimit në të djathtë.

Për ndërtimin e udhëkryqit “Tërfili” Qyteti i Shkupit shpenzoi 39.000.000 denarë. Udhëkryqi u ndërtua 9 muaj në kushtet e zhvillimit të pandërprerë të qarkullimit, kurse u lëshua në përdorim në korrik të këtij viti. Gjatësia e përgjithshme e të gjitha krahëve të udhëkryqit është 2,2 kilometra, është kryer rikonstruksioni i kanalizimit atmosferik dhe është vendosur ndriçimi i plotë rrugor dhe elemente-paver në të gjitha sipërfaqet për këmbësorë.

U KRYE RIKONSTRUKSIONI I URAVE 8 - SEPTEMVRI DHE OBEDINETITE NACII

Me asfaltimin e korsive për këmbësorë dhe biçikleta nga të dyja anët e urave, Qyteti i Shkupit përfundoi në mënyrë të plotë rikonstruksionin e këtyre objekteve infrastrukturore. Kapakët prej beton-armeje u zëvendësuan me të reja, u riparuan trarët dhe u vendosën shtylla mbrojtëse me emblemën e Qytetit të Shkupit.

Qyteti i Shkupit, përveç punëve voluminoze në të dyja urat, gjatë këtij viti realizoi edhe freskimin me bojë të parmakëve prej hekuri në të gjitha urat e tjera.

Qyteti i Shkupit, shpalli konkurs për zgjidhje ideore-trajtësimi të parmakëve dhe ndriçimit të urave tek Holidej In dhe tek Narodna Banka, projekte të cilat duhet të realizohen gjatë vitit të ardhshëm.



Rikonstrukcion i rrugës "Nikolla Krev"



Shënim i rrugëve natën

TRE AUTOMJETE PËR PERSONAT ME INVALIDITET MË TË RËNDË

Mjetet e përgjithshme që ndahen për realizimin e Programit të Qytetit të Shkupit për realizimin e mbrojtjes sociale të personave me nevoja të veçanta në Buxhetin e Qytetit të Shkupit, janë 35 milion denarë dhe janë destinuar për:

- bileta të privileguara (falas) për shfrytëzimin e transportit publik të qytetit për persona me nevoja të veçanta;
- transport të organizuar të studentëve dhe nxënësve me nevoja të veçanta deri te institucionet arsimore;
- transport të organizuar të personave me invaliditet më të rëndë që lëvizin me ndihmën e karrocës së invalidëve dhe
- sigurimin e qasjes së personave me nevoja të veçanta në dy shkolla të mesme të qytetit me vendosjen e ashensorit dhe platformës.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, me rastin e Ditës ndërkom-bëtare të personave me nevoja të veçanta, 3 dhjetori, dha në përdorim 3 automjete speciale të adaptuara për nevojat e personave me invaliditet më të rëndë.

Tre automjetet janë pajisur me platformë automatike speciale për ngritjen e karrocës së invalidëve dhe pajisje tjetër që do të sigurojë sigurinë e shfrytëzuesve.

- Këto automjete do të mundësojnë përmirësimin e kualitetit të jetesës së personave me invaliditet më të rëndë, lëvizshmëri më të madhe të tyre dhe përfshirje në rrjedhat shoqërore. Personat me anë të thirrjes telefonike, do të mund të paraqesin transportin e tyre. Rregullat për organizimin e transportit që sot do të jenë në dispozicion të shoqatave civile, shfrytëzuesve, medimeve dhe publikut më të gjerë – tha Trajanovski.

Të drejtë për shfrytëzimin e transpor-

tit të organizuar me automjete të veçanta të adaptuara do të kenë vetëm personat me invaliditet më të rëndë trupor, të cilët, për shkak të lëvizjes, kanë të nevojshme karrocë për invalidë, persona me pengesa të rënda motorike, si dhe personi që shoqëron shfrytëzuesin. E drejta e shfrytëzimit do të realizohet nëpërmjet shoqatave civile adekuata të organizuara në territorin e Qytetit të Shkupit.

Tre automjetet janë pronësi e Qytetit të Shkupit dhe bashkë me të gjitha pajisjet plotësuese të instaluara do të kushtojnë rreth gjashtë milion denarë. Automjetet i janë dhënë në përdorim Ndërmarrjes së qarkullimit publik – “NQP” – Shkup, e cila do të kryejë transportin dhe në bashkëpunim me shoqatat civile nga kjo fushë të organizuara në territorin e Qytetit të Shkupit, do të realizojnë orarin ditor të udhëtimit.

Transporti do të organizohet dhe kryhet sipas këtyre rregullave:

- dy automjete kryejnë transportin nga ora 08.00 - 22.00, kurse një automjet nga ora 09.00 - 23.00;
- paraqitja e transportit nga ora 8-15 kryhet falas në telefonin: 080015115, kurse pas orës 15 paraqitja kryhet në telefonin 3173-224, kjo thirrje telefonike do të paguhet,
- me një thirrje telefonike mund të paraqitet transporti vetëm për një shfrytëzues deri në një destinacion konkret dhe prapa;

Shfrytëzuesit e transportit të organizuar mund të shfrytëzojnë transportin sipas këtyre prioriteteve:

- shfrytëzimi i mbrojtjes shëndetësore;
- realizimi i të drejtave nga fusha e mbrojtjes sociale;
- realizimi i të drejtave nga fusha e mbrojtjes invalidore;
- vizitë në manifestime sportive, kulturore-zhavitëse dhe manifestime të ngjashme.



Persona pa maska



Nata e Bardhë



Bienale



Matka



Cinedays



Çmime sportive 13-Nëntori



Cinedays



Shiko muzikë dhe dëgjo libër



Shiko muzikë dhe dëgjo libër



Instrumentistë të rrugës



Pivolend



Baskerfest



Oratorë



Kuadril



*Kryetari i Zyrtetit të Shkupit, Koce Trajanovski,
qytetarëve të Shkupit u uron festat e Vitit të
Ri dhe Krishtlindjet dhe në Vitin e Ri 2010 u
dëshiron shëndet, sukses dhe mirëgenie.*



*Kryetarja e Këshillit të
Zyrtetit të Shkupit, Irena Misheva,
qytetarëve të Shkupit u uron festat e
Vitet të Ri dhe Krishtlindjet.*